

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	03/04/2023	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga KQZ:</p> <p>Lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve.</p> <p>Nëpërmjet këtij raporti, është marrë indicie për organizmin e 1 (një) veprimtarie publike nga Institucioni Juaj.</p>	06/04/2023	<p>Për sa kërkonti në lidhje me arsyen e mosraportimit të veprimtarisë objekt denoncimi ju informojmë si në vijim:</p> <p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, shfrytëzimin e qëndrueshëm e shumëfunksional të burimeve pyjore, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.</p> <p>Në përmbushje të misionit të saj Agjencia Kombëtare e Pyjeve, <i>“harton, zbaton dhe monitoron plane, programe e projekte që synojnë miradministrimin, ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor, në bashkëpunim dhe koordinim me institucione në nivel qendror e vendor, me donatorë/partnerë zhvillimorë, me organizma të shoqërisë civile dhe biznesit”</i>. Bashkëpunimi me Njësinë e Vetëqerisjes Vendore është një nga prioritetet e punës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për përmbushjen e misionit të saj, në lidhje me zhvillimin e fondit pyjor, ku bëjnë pjesë edhe projektet e pyllëzimeve.</p> <p>Projekti i pyllëzimeve është hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të Bashkisë. Ky projekt ka nisur të zbatohet që prej vitit 2022 dhe është parashikuar të përfundojë me mbylljen e periudhës së pyllëzimeve të vitit 2023. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kushtet</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>teknike dhe atmosferike që kërkon procesi i pyllëzimeve (mbjellja e fidanëve) nuk mundëson parashikime të ditëve (fikse) për kryerjen e punimeve.</p> <p>Aktiviteti/veprimtaria e objekt denoncimi, nuk është organizuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Në këtë veprimtari institucioni ynë ka qenë thjesht pjesëmarrës në aktivitet dhe për rrjedhojë nuk mund të raportonte për zhvillimin e këtij aktiviteti. Konkretisht, ky aktivitet ishte një ndër aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit të lartpërmendur dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.</p> <p>Sa më sipër dhe në përmbushje të detyrime që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, garanton se do të raportojë në respektim të afateve ligjore çdo aktivitet/veprimtari që do të organizohet nga ana e saj, deri në përfundim të peridhës zgjedhore.</p>		
02	11/04/2023	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një organizatë jofitimprurëse:</p> <p>1- Informacion mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 "PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TE BASHKIVE TË PYJEVE DHE TË KULLOTAVE PUBLIKE, SIPAS LISTAVE TË INVENTARIT DHE AKTUALISHT NË ADMINISTRIM TË</p>	12/04/2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion në lidhje me hartat digjitale të bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec ju sqarojme se Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk disponon harta të këtyre bashkive mbasi pronare dhe administruese të sipërfaqeve pyjore janë Bashkitë.</p> <p>Për informacionin e kërkuar ju mund tju drejtoheni bashkive përkatëse të cilat disponojnë hartat e ekonomive pyjore e kullimore dhe të dhënat e detajuara mbi to.</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>MINISTRISË SË MJEDISIT E TË ISH KOMUNAVE/BASHKIVE"</p> <p>2. Informacion mbi hartat e Bashkive Korçë, Kolonjë, Maliq, Devoll dhe Pogradec të miratuara me VKM nr. 398, datë 13.05.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.433, DATË 08.06.2016, TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE TË PYJEVE DHE TË KULLOTAVE PUBLIKE, SIPAS LISTAVE TË INVENTARIT DHE AKTUALISHT NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MJEDISIT E TË ISH KOMUNAVE/BASHKIVE",</p>				
03	26/05/2023	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetar:</p> <p>1- Sa ka qenë fondi i vënë në dispozicion për këtë sistem monitorimi?</p> <p>2- Sa ka qenë kostoja e një pike monitorimi, si kamera, panelet diellore për të furnizuar me energji të vazhdueshme kamerat, kulla në të cilën ato kanë qenë vendosur? Lutem që të shoqërohen me dokumentacion!</p> <p>3-Cilat kanë qenë rezultatet e këtij sistemi monitorimi,</p>	29/05/2023	<p>Duke ju referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije sa vijon: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve" të ndryshuar është shfuqizuar me VKM nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", botuar në Fletoren Zyrtare 121, datë 3.09.2019, në të cilën është botuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 17.07.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve" e cila ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre,</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>statistikat e bllokimeve të lëndës drusore nga monitorimi online? 4-Çfarë është bërë me këtë sistem elektronik të monitorimit të pyjeve, ku janë aktualisht kamerat e vendosura në terren?</p>	<p>shfrytëzimin e qëndrueshëm e shumëfunksional të burimeve pyjore, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.</p> <p>Sa më lart, me shkrirjen e ISHMPUT dhe ristrukturimin e institucioneve të varësisë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe krijimin e AKP-së, nëpunësit civilë dhe trupat inspektuese të tij kaluan në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe pjesa e Inspektorëve të Policisë Pyjore kaloi në strukturën e pyjeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.</p> <p>Lidhur me pyetjet e parashtruara nga ana juaj, Agjencia Kombëtare e Pyjeve si institucion i ri nuk ka dijeni mbi procedurat e prokurimit të sistemit elektronik të monitorimit të pyjeve, ku gjejnë përgjigje dhe pyetja juaj e dytë, si dhe nuk ka informacion lidhur me pyetjen e tretë, pasi nuk ka trashëguar dokumentacionin e arkiv protokollit të ish ISHMPUT, për të cilin duhet të kërkoni informacion në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>Lidhur me pyetjen e katërt, Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka dijeni se çfarë është bërë me këtë sistem, pasi ky sistem nuk i ka kaluar në përdorim AKP-së dhe lidhur me faktin se kush e disponon, është në funksionim apo jo, si dhe gjendjen fizike dhe teknike të stacioneve të kamerave në territor duhet të kërkoni informacion në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.</p>		
--	--	--	--	--	--